

VENDIM
Nr. 361, datë 6.5.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 221, DATË 26.4.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 1, shkronja “b”, e 11, pika 3, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 4, të kreut III, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Fjalja e dytë, e shkronjës “d”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Pranon kërkesat dhe shqyrton dokumentacionin tekniko-ligjor të paraqitur nga subjektet fizike dhe juridike që kërkojnë miratim, në parim, për nisjen e një procedure koncesioni, për leje, për autorizim për përdorim burimi ujor, për veprimtari ndërtimore në brigje, për veprimtari në shtratin e burimit ujor dhe shkarkime të lëngshme, si dhe bën propozimet përkatëse në Këshillin Kombëtar të Ujit ose në Këshillin e Basenit Ujor, sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për miratimin e veprimtarisë përkatëse.”;

b) Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “dh/1”, me këtë përmbajtje:

“dh/1. I propozon K KU-së dhe/ose KBU-së rishikimin, pezullimin, shfuqizimin ose anulimin e lejeve, autorizimeve;”.

2. Në shkronjën “a”, të pikës 5, të kreut III, bëhen këto ndryshime:

a) Nënndarja “ii” shfuqizohet;

b) Nënndarja “iii” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“iii. I propozon KBU-së rishikimin, shfuqizimin ose anulimin e vendimeve, që nuk kanë të bëjnë me dhënien e lejeve dhe të autorizimeve;”.

II. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, këshillat e baseneve ujore dhe zyrat e administrimit të baseneve ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama